UNIVERSITETI I PRISHTINES

FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE

FEVZI BERISHA

PERGJITHESIMI I MODULEVE TE VAZHDÜESHMERISE NE TEORINE E PERAFRIMEVE

(Disertacioni i doktoranturës)

MENTORI,
DR. M.K. PATAPOV

PRISHTINE, 1989.

P E R M B A J T J A

H Y R J E

Në disertacion do të shqyrtohet lidhmëria e përgjithsimit të modulit të vazhdueshmërisë me përafrimin më të mirë të funksioneve me anë të polinomeve algjebrike.

Të paraqesim disa shprehje dhe përkufizime të nevojshme për paraqitjen e rezultateve themlore të këtij punimi.

Do të themi, që $f(x) \in \bar{L}_p$, $1 \leq p \leq \infty$, në qoftë se $f(x)$ është funksion periodik me periodë 2π, si dhe për $1 \leq p < \infty$, $f(x)$ i matshëm në $[0,2\pi]$ dhe

$$\| f \|_{\bar{L}_p} = \left(\int_0^{2\pi} |f(x)|^p \, dx \right)^{\frac{1}{p}} < \infty,$$

ndërsa, për $p = \infty$, $f(x)$ i vazhdueshëm në $[0,2\pi]$ dhe

$$\| f \|_{\bar{L}_\infty} = \| f \|_C = \max_{0 \leq x \leq 2\pi} |f(x)| .$$

Shenojmë me $\bar{E}_n(f)_p$ përafrimin më të mirë të funksionit $f(x) \in \bar{L}_p$, me anë të polinomeve trigonometrike $T_n(x)$ të shkallës jo më të lartë se $n-1$, në metrikën L_p, pra:

$$\bar{E}_n(f)_p = \inf_{T_n} \| f(x) - T_n(x) \|_{L_p}$$

Shenojmë me $\bar{\omega}_k(f,\delta)_p$ modulin e thjeshtë të lëmueshmërisë të rendit k të funksionit $f(x) \in L_p$, pra

$$\bar{\omega}_k(f,\delta)_p \quad \sup_{|t| \leq \delta} \|\Delta_t^k f(x)\|_{L_p} ,$$

ku

$$\Delta_h^k f(x) = \sum_{i=0}^{k} (-1)^{k+i} C_k^i f(x+ih)$$

kemi shenuar diferencën e rendit k me hapin h të funksionit $f(x)$.

Në qoftë se $\bar{\omega}_1(f,\delta) = O(\delta^\gamma)$, atëherë shenojmë $f(x) \in \bar{L}ip(\gamma,p)$. Me $Lip(\gamma,p)$ kemi shenuar klasën e Lipshicit të rendit të dhënë γ.

Gjithashtu do të themi, që $f(x) \in L_p$, $1 \leq p \leq \infty$, në qoftë se, për $1 \leq p < \infty$ funksioni $f(x)$ i matshëm në $[-1,1]$ dhe

$$\|f\|_{L_p} = \left(\int_{-1}^{1} |f(x)|^p dx \right)^{\frac{1}{p}} < \infty ,$$

ndërsa, $p = \infty$, funksioni $f(x)$ i vazhdueshëm në segmentin $[-1,1]$ dhe

$$\|f\|_{L_\infty} = \|f\|_C = \max_{-1 \leq x \leq 1} |f(x)|$$

Në këtë punim, kryesisht, do të shqyrtohen funksionet $f(x)$ që i takojnë hapsirës $L_{p,\alpha,\beta}$, d.m.th. funksionet e tilla që prodhimi $f(x)(1-x)^{\alpha}(1+x)^{\beta}\in L_p$, pra

$$\|f\|_{L_{p,\alpha,\beta}} = \|f(x)(1-x)^{\alpha}(1+x)^{\beta}\|_{L_p} .$$

Me $E_n(f)_{p,\alpha,\beta}$, do të shenojmë përafrimin më të mirë të funksionit $f(x)\in L_{p,\alpha,\beta}$, me anë të polinomeve algjebrike $P_n(x)$ të shkallës jo më të lartë se $n-1$ në metrikën $L_{p,\alpha,\beta}$, pra,

$$E_n(f)_{p,\alpha,\beta} = \inf_{P_n} \|f(x) - P_n(x)\|_{L_{p,\alpha,\beta}}$$

Për funksionet periodike me periodë 2π, është mirë e njohur teorema e Xheksonit dhe teorema e anasjelltë (inverze) me te, të cilat paraqesin lidhshmërinë e modulit të lëmueshmërisë dhe përafrimit më të mirë të këtyre funksioneve me polinomet trigonometrike në metrikën $\bar{L}_p$:

Teorema A. Le të jetë $f(x)\in \bar{L}_p$, $1 < p < \infty$. Atëherë konditat $f(x)\in \overline{Lip}(\gamma,p)$ dhe $\bar{E}_n(f)_p = 0(n^{-\gamma})$ $(0<\gamma<1)$ janë ekuivalente.

Teorema B. Le të jetë $f(x)\in \bar{L}_p$, $1 < p < \infty$. Atëherë për çdo numër natyral n vlejnë jobarazimet:

$$\bar{E}_n(f)_p < C_1\ \bar{\omega}_k(f, \tfrac{1}{n})_p ,$$

$$\bar{\omega}_k(f, \frac{1}{n}) < \frac{C_2}{n^k} \sum_{\nu=1}^{n} \nu^{k-1} \bar{E}_\nu(f)_p^{\frac{1}{p}}$$

ku konstantet C_1 dhe C_2 nuk varen nga $f(x)$ dhe n.

Qysh në fillim të këtij shekulli është sqaruar, që për funksionin e vazhdueshëm joperiodik kondita $f(x) \in Lip\, \gamma\, (0 < \gamma < 1)$ në tërë segmentin $[-1,1]$ nuk është ekuivalente me konditën $E_n(f)_{C[-1,1]} = O(n^{-\gamma})$. Kjo do të thotë, që për modulet e thjeshtë të lëmueshmërisë të funksioneve të vazhdueshme joperiodike aq më parë nuk vlen teorema B.

Për këtë arsye që në fillim janë paraqitur dy probleme:

1) Gjetja e karakteristikave konstruktive të klasës së funksioneve joperiodike që e plotësojnë konditën e Lipshicit të rendit γ d.m.th. klasës së funksioneve $Lip\,(\gamma, p)$.

2) Gjetja e karakteristikave strukturale të klasës së funksioneve joperiodike që plotësojnë konditën:

$$E_n(f)_{p,\alpha,\beta} < C\, n^{-\gamma}$$

Problemi i parë është zgjidhur plotësisht në metrikën uniforme.

Në fillim, me 1946 S.M. Nikolski [1] ka konstatuar, që karakteristika konstruktive e funksioneve të vazhdueshme joperiodike në tërë segmentin $[-1,1]$ duhet të varet nga pozita e pikës në këtë segment. E pastaj më vonë në punimet e A.F. Timanit [2] , V.K. Djadik [3] dhe G. Fred [4] një konstatim i tillë është vërtetuar.

Faktikisht është vërtetuar ky pohim: që funksioni i vazhdueshëm joperiodik në segmentin $[-1,1]$ t'i takojë klasës Lip γ, $0 < \gamma < 1$ (në tërë segmentin $[-1,1]$), kondità e nevojshme dhe e mjaftueshme është që për çdo numër natyral n të gjendet polinomi algjebrik $P_n(x)$ i shkallës jo më të lartë se $n-1$, i tillë që të plotëson konditën:

$$|f(x) - P_n(x)| \leq C(n^{-1}\sqrt{1-x^2} + n^{-2})^{\gamma}, \quad x \in [-1,1], \qquad (1)$$

Kjo konditë nuk mund të bartët në metrikat $L_p[-1,1]$ $1 \leq p < \infty$. De Vore [5], V.P. Motornij [6] duke shfrytëzuar rezultatet e G.K. Lebedit [7] dhe M.K. Potapovit [8], [9] kanë vërtetuar që kondita:

$$\inf \|(\sqrt{1-x^2} + n^{-1})^{-\gamma} (f(x) - P_n(x))\|_{L_p[-1,1]} = O(n^{-\gamma}) \quad (2)$$

nuk paraqet karakteristikat konstruktive të klasës Lip(γ,p).

Për këtë arsye më vonë është shqyrtuar problemi i sqarimit të karakteristikave konstruktive të klasës së funksioneve $f(x) \in L_p$, që plotësojnë konditën (2).

Në një varg rastesh (shih p.sh. [7] dhe [10] është gjetur zgjidhja e këtij problemi.

Në këtë punim do të shqyrtohet ky problem për funksionet të cilat plotësojnë konditën më të përgjithëshme se kondita (2).

Në vitet e 50-ta është tregua, që problemi i dytë i paraqitur më lartë, në metrikën $C[-1,1]$ do të ketë zgjidhje në qoftë se shëndrrohet në rastin trigonometrik, përkatësisht ka vend ky pohim: që funksioni $f(x)$ joperiodik i vazhdueshëm në segmentin $[-1,1]$ të plotësojë jobarazimin:

$$E_n(f)_C = O(n^{-\gamma})$$

kondità e nevojshme dhe e mjaftueshme është që funksioni $f(x)$ të plotësojë konditën:

$$\| f(x) - f(x \tilde{\mp} h) \|_C = O(|h|^{\gamma})$$

funksioni $f(x \tilde{+} h) = \frac{1}{2} [f(x \cos t + \sqrt{1-x^2} \sin t) + f(x \cos t - \sqrt{1-x^2} \sin t)]$, $h = \sin t$, quhet funksion i translacionit të përgjithshëm të tipit të Çebishevit.

Pastaj, në një varg punimesh [11 - 21] ky problem është shqyrtuar dhe zgjidhur detalisht. Në këto punime problemi është zgjidhur në termin të përkufizimit të funksionit të translacionit të përgjithshëm të tipit të Jakobit $f(x,t,\nu,\mu)$ (ku si rast i veçantë paraqitet funksioni i përmendur i translacionit të përgjithshëm të tipit të Çebishevit). Poashtu në një varg rastesh janë vërtetuar teoremat analoge me teoremën B (për $1 < p < \infty$), por në këto punime influenca $(1-x)^{\alpha}$ $(1+x)^{\beta}$ ka qenë ngushtë e lidhur me funksionin e translacionit të përgjithshëm: $\alpha = \frac{\nu}{p}$, $\beta = \frac{\mu}{p}$.

Në vitet e fundit po shqyrtohet problemi se në ç'mënyrë ose si është i "lidhur" translacioni i përgjithshëm $f(x,t,\nu,\mu)$ me influencën e shqyrtuar $(1-x)^{\alpha}$ $(1+x)^{\beta}$. Zgjidhja e problemit të tillë p.sh. është paraqitur në punimet [23 — 26] . Në këto punime është vërtetuar, se translacioni i përgjithsëm i tipit të Jakobit mund të shqyrtohet vetëm për influencën $(1-x)^{\alpha_1}$ $(1+x)^{\beta_1}$ të tillë që α_1 dhe β_1 duhet të plotësojnë disa jobarazime të dhënë më parë. Po ashtu translacioni i përgjithshëm i tipit të Çevishevit mund të shqyrtohet vetëm në qoftë se $\alpha = \beta = -\frac{1}{2p}$

Prandaj edhe natyrsisht se paraqitet problemi i përkufizimit të një moduli të përgjithshëm të vazhdueshmërisë të tillë që translacioni i përgjithshëm të mos varet nga influenca e hapsirës së shqyrtuar dhe për të cilin do të vlejë teorema analoge me teoremën B.

Këtu do të shqyrtohet përgjithësimi i modulit të vazhdueshmërisë të përkufizuar me anë të translacionit të përgjithshëm të tipit të Çebishevit që nuk varet nga influenca e hapsirës së shqyrtuar. Për këtë modul të vazhdueshmërisë vërtetohet teorema analoge me teoremën B, si dhe është dhënë karakteristika konstruktive e klasës së funksioneve që plotësojnë konditën më të fuqishme se kondita (2).

Në kapitullin e parë do të përkufizohen modulet e njohur më parë dhe paraqitën vetit themelore të këtyre moduleve. Për funksionet joperiodike nga klasa $L_{p,\alpha,\beta}$ përkufizohet një tip i përgjithshëm i modulit të vazhdueshmërisë. Duke u bazuar në lemën e vërtetuar në këtë kapitull pastaj në mënyrë analoge do të paraqitën dhe do të vërtetohen disa veti të këtij moduli të përgjithshëm të vazhdueshmërisë të përkufizuar më parë. Në paragrafin 1.4 janë paraqitur disa përkufizime dhe pohime ndihmëse të cilat janë të nevojshme për vërtetimin e rezultateve themelore të këtij punimi.

Në kapitullin e dytë shqyrtohen dhe vërtetohen teoremat e tipit të Xheksonit për modulin e vazhdueshmërisë $\tilde{\omega}(f,\delta)_{p,\alpha,\beta}$. Këtu vërtetohet teorema e drejtë dhe e anasjelltë në teorinë e përafrimeve. Gjithashtu bëhet vlerësimi i modulit të përkufizuar me anë të përafrimeve të funksioneve joperiodike me polinome algjebrike. Vërtetimi i teoremës së drejtë në teorinë e përafrimeve bëhet duke përdorur një metodologji të re. Këtu më parë përkufizohet K- funksionela e cila pastaj vërtetohet se është ekuivalente me modulin e vazhdueshmërisë $\tilde{\omega}(f,\delta)_{p,\alpha,\beta}$ në metrikën $L_{p,\alpha,\beta}$. Në paragrafin 2.4 formulohet dhe vërtetohet teorema e cila jep vlerësimin e përafrimit më të mirë të funksionit të vazhdueshëm me anë të polinomeve algjebrike dhe normës së derivatit të këtij funksioni të vazhdueshëm. Duke u bazuar në këto teorema pastaj pa vështërsi vërtetohet teorema analoge me teoremën e Xheksonit. Vërtetimi i teoremës së anasjelltë në teorinë e përafrimit bëhet sipas një sheme e cila përdoret për vërtetimin e teoremave të formës së tillë. Pra në mënyrë analoge sikurse tek vërtetimi për funksionet periodike. Teorema e drejtë dhe teorema e anasjelltë paraqesin karakteristikat strukturale të një klase të funksioneve nga klasa L_p. Andaj edhe në këtë kapitull është paraqitur klasa e funksioneve të tilla që plotësojnë konditën më të fuqishme se kondita (2).

Në kapitullin e tretë përkufizohet dhe shqyrtohet një tip tjetër i përgjithësimit të modulit të vazhdueshmërisë me translacion. Këtu translacioni nuk varet nga influenca e klasës L_p. Për modulin e përkufizuar $\omega(f,\delta)_{p,\alpha,\beta,\rho_1,\rho_2}$ po ashtu vërtetohet teorema e drejtë dhe teorema e anasjelltë në teorinë e përafrimeve. Përkufizohet ndonjë funksionellë e cila vërtetohet se është ekuivalente me këtë modul. Teoremat e formuluara dhe të vërtetuara të tipit të Xheksionit në këtë kapitull poashtu japin karakteristikat strukturale të një klase tjetër të funksioneve nga klasa $L_{p,\alpha,\beta}$. Sikurse kapitujt tjerë edhe ky kapitull paraqet një tërësi.

Të gjitha rezultatet themelore të këtij punimi janë origjinale dhe janë paraqitur në seminarin nga teoria e përafrimeve të mbajtur në Moskvë gjatë vitit 1989.

I MODULET FUNKSIONALE

Në analizën matematike e posaqërisht në teorinë e përafrimeve që të përcaktohen karakteristikat e funksioneve përdoren të ashtuquajturit "modulet funksionale". Në këtë kapitull do të shqyrtohen modulet e thjeshtë të vazhdueshmërisë, modulet e lëmueshmërisë dhe përgjithësimet e tyre si dhe përgjithësimi i moduleve të vazhdueshmërisë të cilët do të jenë edhe bazë të këtij punimi.

1.1. MODULET E VAZHDUESHMËRISË DHE MODULET E LËMUESHMËRISË

Le të jetë $f(x)$ një funksion i kufizuar në ndonjë segment $[a,b]$.

Përkufizimi 1.1. Modul të vazhdueshmërisë të funksionit $f(x)$ e quajmë këtë funksion prej $\delta\in[0,b-a]$:

$$\omega(f,\delta)=\left\{\sup|f(x_1)-f(x_2)|;|x_1-x_2|<\delta,x_1,x_2\in[a,b]\right\}$$

E thënë në mënyrë jo rigoroze, moduli i vazhdueshmërisë tregon se sa mund të ndryshojë njëra nga tjetra dy vlera të funksionit $f(x)$, në qoftë se dihet që vlerat e argumentit ndryshojnë, jo më shumë se δ. Përkatësisht, moduli i vazhdueshmërisë $\omega(f)$ i funksionit f e karakterizon madhësinë e oscilimit më të madh të funksionit $f(x)$ në segmentin me gjatësi $\delta > 0$.

Kondità e nevojshme dhe e mjaftueshme që funksioni $f(x)$ të jetë i vazhdueshëm në segmentin $[a,b]$ është që të plotësohet kondita:

$$\lim_{\delta \to 0} \omega(f,\delta) = \omega(f,0) = 0$$

Vërtetimi i kësaj vetie është i qartë.

Si përgjithësim i natyrshëm i moduleve të vazhdueshmërisë përdoren modulet e lëmueshmërisë.

Për funksionin e dhënë $f(x)$ (të kufizuar) përkufizojmë diferencën e k-të me hapin h në pikën x në këtë mënyrë:

$$\Delta_h^k f(x) = \sum_{m=0}^{k} (-1)^{m+k} \binom{k}{m} f(x+mk)$$

Le të jetë $f(x)$ funksion i kufizuar në segmentin $[a,b]$ dhe k- një numër natyral i çfarëdoshëm.

Përkufizimi 2.1. Modul i lëmueshmërisë i rendit k i funksionit $f(x)$ quhet funksioni:

$$\omega_k(f,\delta) = \sup\left\{ |\Delta_h^k f(x)| \; : \; |h| < \delta, x, x+kh \in [a,b] \right\}$$

ku $\delta \in [0, \frac{b-a}{k}]$

Është e qartë se moduli i lëmueshmërisë i rendit të parë në tërësi përputhet me modulin e thjeshtë të vazhdueshmërisë, d.m.th. $\omega_1(f,\delta) = \omega(f,\delta)$. Ndërsa në të shumtën e rasteve moduli i lëmueshmërisë i rendit të dytë $\omega_2(f,\delta)$ quhet edhe moduli i Zigmundit.

Po paraqesim disa veti të cilat i gëzon moduli i lëmueshmërisë:

1) Funksioni $\omega_k(f,\delta)$ është monotono jo zvogëlues:

$$\omega_k(f,\delta_1) < \omega_k(f,\delta_2) \;, \quad \text{për} \quad 0 < \delta_1 < \delta_2$$

2) Funksioni $\omega_k(f,\delta)$ gëzon vetin e gjysëmadivitetit:

$$\omega_k(f,\delta_1+\delta_2) < \omega_k(f,\delta_1) + \omega_k(f,\delta_2)$$

3) Moduli i rendit më të lartë vlerësohet me anë të modulit të rendit më të ultë:

$$\omega_k(f,\delta) < 2\,\omega_{k-1}(f,\delta)$$

4) Moduli i lëmueshmërisë së funksionit vlerësohet me anë të modulit të rendit më të ultë të derivatit të atij funksioni:

$$\omega_k(f,\delta) \leq \delta\ \omega_{k-1}(f',\delta)$$

5) Faktori i plotë mund të shkruhet para shenjës së modulit:

$$\omega_k(f,n\delta) \leq n^k\ \omega_k(f,\delta)$$

5') Faktori i çfarëdoshëm mund të shkruhet para shenjës së modulit në këtë mënyrë:

$$\omega_k(f,\lambda\delta) \leq (\lambda+1)^k\ \omega_k(f,\delta)\ , \quad \lambda > 0\ .$$

Vetit 1) dhe 2) rrjedhin drejtëpërsëdrejti nga përkufizimi i modulit të lëmueshmërisë ndërsa vërtetimin e vetive 3), 4) dhe 5) p.sh. shiqo në monografin ([27], f. 21).

Përveç pesë vetive themelore të përmendura moduli i lëmueshmërisë $\omega(f,\delta)$ e gëzon edhe një veti specifike:

6) Moduli $\omega(f,\delta)$ vlerësohet me anë të normës së derivatit të funksionit:

$$\omega(f,\delta) \leq \delta\ \| f' \|_{C[a,b]}$$

Vërtetimin shih [27], f. 24.

Vetia 3) tregon se modulin $\omega_k(f,\delta)$ mund ta vlerësojmë me anë të modulit $\omega_i(f,\delta)$ për çdo $i < k$. Pohimi i anasjelltë, vlerësimi i modulit më të ultë me anë të modulit të rendit më të lartë është më i ndërlikuar. Ai rrjedh nga kjo teoremë e Marshit.

Teorema Marshi [28] . Për çdo $i < k$ vlen jobarazimi:

$$\omega_i(f,\delta) < C_k \ \delta^i \left\{ \int_0^{(b-a)/k} t^{-i-k} \ \omega_k(f,t)dt + \right.$$

$$\left. + (b-a)^{-i} \| f \|_{C[a,b]} \right\}$$

ku konstanta C_k varet vetëm nga k .

1.2. MODULET INTEGRALE

Në qoftë se përdorim normën integrale, atëherë fitohen modulet analoge me modulet e lëmueshmërisë të cilët i quajmë modulet integrale të lëmueshmërisë ose thjeshtë modluet e lëmueshmërisë në metrikën L_p.

Le të jetë $f(x) \in L_p[a,b]$

Përkufizimi 1.3. Modul integral (modul të lëmueshmërisë në L_p, ose p-modul) të rendit k të funksionit $f(x)$ ose thjesht modul të lëmueshmërisë në metrikën L_p e quajmë funksionin:

$$\omega_k(f,\delta)_p = \sup_{0<h<\delta} \| \Delta_h^k f(x) \|_{L_p[a,b]}, \quad \delta \in [0, \frac{b-a}{k}]$$

Të vërtetojmë një veti karakteristike të modulit integral $\omega_1(f,\delta)_1 = \omega(f,\delta)_L$.

7) Në qoftë se funksioni $f(x)$ është me variacion të kufizuar në segmentin $[a,b]$, atëherë:

$$\omega(f,\delta)_L < \frac{\delta}{b-a} \; V_a^b \, f(x)$$

Me të vërtetë,

$$\int_a^{b-h} |f(x+h) - f(x)| \, dx < \int_a^{b-h} V_x^{x+h} f(x) \, dx =$$

$$= \int_a^{b-h} (V_a^{x+h} f(x) - V_a^x f(x)) \, dx = \int_{a+h}^{b} V_a^x f(x) \, dx -$$

$$- \int_a^{b-a} V_a^x f(x) \, dx < h \, V_a^b f(x) .$$

Eshtë me rëndësi të cekët në këtë rast se mosbarazimi i mësipërm vlenë edhe në anën tjetër. Ky fakt rrjedh nga teorema Hardi-Litelvud ([28], f. 117).

1.3. PËRGJITHËSIMI I MODULEVE TË VAZHDUESHMËRISË

Për funksionet periodike teorema e Xheksonit dhe e anasjellta me te japin lidhjen e modulit të vazhdueshmërisë të këtyre funksioneve me përafrimin më të mirë të tyre me polinome trigonometrike. Për funksionet joperiodike akoma nuk është vërtetuar një lidhje e tillë e modulit të vazhdueshmërisë dhe përafrimit më të mirë të tyre me polinome algjebrike. Në shumë punime të publikuara në vitet e fundit është vërtetuar se analogjia e plotë me rastin e funksioneve trigonometrike do të vlejë atëherë në qoftë se moduli i thjeshtë i vazhdueshmërisë zëvendësohet me përgjithësimin e modulit të vazhdueshmërisë.

Kështu M.K. Patapov në punimin [23] përgjithësimin e modulit të vazhdueshmërisë e përkufizon në këtë mënyrë:

$$\tilde{\omega}(f,\delta,p,\nu,\mu) = \sup_{|t|<\delta} \| f(x) - f(x,t,\nu,\mu) \|_{L_p^{\nu,\mu}}$$

ku $f(x,t,\nu,\mu)$ është funksion i translacionit të përgjithshëm. Për këtë modul vërtetohen teorema analoge me teoremën e Xheksonit si dhe teorema e anasjelltë me te.

Në punimin [24] një tip i përgjithshëm i modulit të vazhdueshmërisë përkufizohet në këtë mënyrë:

$$\Omega(f,\delta)_{p,\lambda} = \sup_{|t|<\delta} \| [T_t^{\lambda}(f,x) - f(x)](1+x)^{\frac{\lambda}{2}} \|_p$$

ku $T_t^{\lambda}(f,x)$ quhet operator i translacionit të përgjithshëm dhe paraqitet në këtë formë:

$$T_t^{\lambda}(f,x) = \frac{1}{\pi(\cos\frac{t}{2})^{\lambda}} \int_0^{\pi} f(\cos\theta)\left(\frac{1+\cos\theta}{1+x}\right)^{\frac{\lambda}{2}} \cos\lambda r d\varphi ,$$

$$|t| < \pi, \quad \cos\theta = x\cos t + \cos\varphi \sin t\sqrt{1-x^2}, \quad 0 \leq r \leq \pi$$

$$\cos r = \frac{\sqrt{1+x}\cos\frac{t}{2} + \cos\varphi\sqrt{1-x}\sin\frac{t}{2}}{\sqrt{1+x\cos t + \cos\varphi\sqrt{1-x^2}\sin t}}$$

Edhe për këtë modul vërtetohet teorema e drejtë dhe teorema e anasjelltë në teorinë e përafrimeve.

Po shqyrtojmë përgjithësimin e një tipi të modulit të vazhdueshmërisë i cili është analog me modulin e thjeshtë të lëmueshmërisë të rendit të parë për funksionet periodike me periodë 2π .

Le të jetë $f(x) \in L_{p.\alpha.\beta}[-1,1]$.

Përkufizimi 1.4. Përgjithësim i modulit të vazhdueshmërisë i funksionit $f(x) \in L_{p,\alpha,\beta}[-1,1]$ quhet funksioni:

$$\tilde{\omega}(f,\delta)_{p,\alpha,\beta} = \sup_{0 < t < \delta}\left\{\left[\int_{0}^{\pi-\lambda} |f(\cos(\theta+t)) - f(\cos\theta)|^{p}(\sin\tfrac{\theta}{2})^{2p\alpha+1}(\cos\tfrac{\theta}{2})^{2p\beta+1}d\theta\right]^{\frac{1}{p}} + \left[\int_{\lambda}^{\pi}|f(\cos(\theta-t)) - f(\cos\theta)|^{p}(\sin\tfrac{\theta}{2})^{2p\alpha+1}(\cos\tfrac{\theta}{2})^{2p\beta+1}d\theta\right]^{\frac{1}{p}}\right\}$$

për $1 \leq p < \infty$, ndërsa për $p = \infty$, funksionin:

$$\tilde{\omega}(f,\delta)_{\infty,\alpha,\beta} = \sup_{0 \leq t \leq \delta}\left\{\max_{0<\theta<\pi-\lambda}\left[|f(\cos(\theta+t)) - f(\cos\theta)|(\sin\tfrac{\theta}{2})^{2\alpha}(\cos\tfrac{\theta}{2})^{2\beta}\right] + \max_{\lambda<\theta<\pi}\left[|f(\cos(\theta-t)) - f(\cos\theta)|(\sin\tfrac{\theta}{2})^{2\alpha}(\cos\tfrac{\theta}{2})^{2\beta}\right]\right\}$$

ku $0 < \delta < \mu < \lambda$, $1 < \lambda < \frac{\pi}{2}$, λ dhe μ janë numra të fiksuar.

Për $\lambda = \frac{3\pi}{8}$ një modul i tillë për herë të parë është përkufizuar në punimin [29] . Ky modul është shfrytëzuar për vlerësimet e përafrimit më të mirë të funksioneve me anë të polinomeve algjebrike dhe ate në metrikën L_2.

Që të vërtetojmë disa veti të këtij moduli $\tilde{\omega}(f,\delta)_{p,\alpha,\beta}$ të cilat veti do të zbatohen në kapitujt e ardhshëm është e nevojshme kjo lemë.

Lema 1.1. Në qoftë se $\alpha > -\frac{1}{2p}$, $\beta \geq -\frac{1}{2p}$, për $1 \leq p < \infty$ dhe $\alpha \geq 0$, $\beta \geq 0$ për $p = \infty$, atëherë ekzistojnë konstantet pozitive C_1, C_2 dhe C_3 për të cilat vlejnë jobarazimet:

për $0 \leq \theta \leq \pi-\lambda$, $0 \leq h \leq \delta < \mu$, $\mu < \lambda < \frac{\pi}{2}$

$$(\sin\tfrac{\theta}{2})^{2p\alpha}(\cos\tfrac{\theta}{2})^{2p\beta}\sin\theta \leq C_1(\sin\tfrac{\theta+h}{2})^{2p\alpha}(\cos\tfrac{\theta+h}{2})^{2p\beta}\sin(\theta+h) \tag{1.1}$$

për $\lambda < \theta < \pi$, $0 \leq h \leq \delta < \mu$, $\mu < \lambda < \frac{\pi}{2}$,

$$(\sin\tfrac{\theta}{2})^{2p\alpha}(\cos\tfrac{\theta}{2})^{2p\beta}\sin\theta \leq C_2(\sin\tfrac{\theta-h}{2})^{2p\alpha}(\cos\tfrac{\theta-h}{2})^{2p\beta}\sin(\theta-h) \tag{1.2}$$

për $\lambda < \theta < \pi$, $0 \leq h \leq \delta < \mu$, $\mu < \lambda < \frac{\pi}{2}$,

$$1 \leq C_3(\sin\tfrac{\theta}{2})^{2p\alpha}(\cos\tfrac{\theta}{2})^{2p\beta} \tag{1.3}$$

ku konstantet $C_i = C_i(p,\alpha,\beta,\lambda-\mu)$, $i = 1,2,3$ nuk varen nga θ dhe h.

Vërtetimi: Kemi:

$$\sin\frac{\theta}{2} = \sin\frac{\theta+h-h}{2} \leq \sin\frac{\theta+h}{2} + \sin\frac{h}{2}$$

Meqë, $0 \leq \frac{h}{2} \leq \frac{h+\theta}{2} < \frac{\pi-\lambda+\mu}{2} = \frac{\mu}{2} - \frac{\lambda-\mu}{2} < \frac{\pi}{2}$, atëherë

$\sin \frac{h}{2} \leq \sin \frac{h+\theta}{2}$, prandaj $\sin\frac{\theta}{2} \leq 2 \sin \frac{\theta+h}{2}$,

për $2p\alpha + 1 \geq 0$, kemi:

$$(\sin\frac{\theta}{2})^{2p\alpha+1} \leq C_4(p, \ )(\sin \frac{\theta+h}{2})^{2p\alpha+1} \tag{1.4}$$

Meqë $0 < \frac{\theta+h}{2} < \frac{\pi-\lambda+\mu}{2} = \frac{\pi}{2} - \frac{\lambda-\mu}{2} < \frac{\pi}{2}$, atëherë:

$\cos \frac{\theta}{2} \leq 1$, $\cos \frac{\theta+h}{2} \geq \cos (\frac{\pi}{2} - \frac{\lambda-\mu}{2}) = \sin \frac{\lambda-\mu}{2} = C_5(\lambda-\mu) > 0$,

prandaj:

$\cos \frac{\theta}{2} \leq C_5 \cos \frac{\theta+h}{2}$

për $2p\beta + 1 \geq 0$, kemi:

$$(\cos\frac{\theta}{2})^{2p\beta+1} \leq C_6(\cos \frac{\theta+h}{2})^{2p\beta+1} \tag{1.5}$$

Kështu, nga jobarazimet (1,4) dhe (1.5) rrjedh jobarazimi (1.1).

Të vërtetojmë jobarazimin (1.2). Le të jetë:

$0 < \frac{\lambda-\mu}{2} \leq \frac{\theta-h}{2} = \frac{\theta}{2} - \frac{h}{2} < \frac{\theta}{2} < \frac{\pi}{2}$,

atëherë: $\sin \frac{\theta}{2} \leq 1$ dhe $\sin \frac{\theta-h}{2} \geq \sin \frac{\lambda-\mu}{2} = C_5(\lambda-\mu) > 0$.

Për këtë arsye vlenë jobarazimi:

$\sin \frac{\theta}{2} \leq C_5 (\sin \frac{\theta-h}{2})$

për $2p\alpha + 1 \geq 0$, kemi:

$$(\sin \frac{\theta}{2})^{2p\alpha+1} \leq C_7 (\sin \frac{\theta-h}{2})^{2p\alpha+1} \tag{1.6}$$

Meqë $0 < \frac{\theta - h}{2} < \frac{\theta}{2} < \frac{\pi}{2}$, atëherë $\cos\frac{\theta}{2} \leq \cos\frac{\theta - h}{2}$,

për $2p\beta + 1 > 0$, kemi:

$$\left(\cos\frac{\theta}{2}\right)^{2p\beta+1} \leq C_8\left(\cos\frac{\theta-h}{2}\right)^{2p\beta+1} \qquad (1.7)$$

Nga jobarazimet (1.6) dhe (1.7) rrjedh jobarazimi (1.2).

Të vërtetojmë tani jobarazimin (1.3). Le të jetë:

$$\lambda < \theta < \pi-\lambda\ , \quad 0 < \frac{\lambda}{2} < \frac{\theta}{2} < \frac{\pi-\lambda}{2} = \frac{\pi}{2} - \frac{\lambda}{2} < \frac{\pi}{2}\ ,$$

atëherë:

$\cos\frac{\theta}{2} > \cos\frac{\pi-\lambda}{2} = \sin\frac{\lambda}{2} > 0$ dhe $\sin\frac{\theta}{2} > \sin\frac{\lambda}{2} > 0$, prandaj

$1 < C_9 \cos\frac{\theta}{2}$ dhe $1 < C_{10}\sin\frac{\theta}{2}$.

Meqë $1 < C_9 \cos\frac{\theta}{2}$, për $2p\beta + 1 > 0$, kemi:

$$1 < C_{11}\left(\cos\frac{\theta}{2}\right)^{2p\beta+1} \qquad (1.8)$$

Meqë $1 < C_{10}\sin\frac{\theta}{2}$, për $2p\alpha + 1 > 0$, kemi:

$$1 < C_{12}\left(\sin\frac{\theta}{2}\right)^{2p\alpha+1} \qquad (1.9)$$

Nga jobarazimet (1.8) dhe (1.9) rrjedh jobarazimi (1.3).

Përgjithësimi i modulit të vazhdueshmërisë gëzon këto veti themelore të cilat janë analoge me vetitë e moduleve tjerë të njohur më parë:

1) Në qoftë se $f(x) \in L_{p,\alpha,\beta}$, atëherë $\tilde{\omega}(f,\delta)_{p,\alpha,\beta}$ është i fundëm për çdo δ dhe $\tilde{\omega}(f,0)_{p,\alpha,\beta} = 0$.

2) $\widetilde{\omega}(f,\delta)_{p,\alpha,\beta}$ - është funksion jo zvoglues d.m.th.

$$\widetilde{\omega}(f,\delta_1)_{p,\alpha,\beta} \leqslant \widetilde{\omega}(f,\delta_2)_{p,\alpha,\beta} \quad , \text{ për } \quad 0 \leqslant \delta_1 \leqslant \delta_2$$

3) Për funksionin $\widetilde{\omega}(f,\delta)_{p,\alpha,\beta}$ vlenë joabarazimi:

$$\widetilde{\omega}(f,\delta_1+\delta_2)_{p,\alpha,\beta} \leqslant C(p,\alpha,\beta,\lambda-\mu)[\widetilde{\omega}(f,\delta_1)_{p,\alpha,\beta} + \widetilde{\omega}(f,\delta_2)_{p,\alpha,\beta}]$$

4) Për çfaredo numri natyral n plotësohet jobarazimi:

$$\widetilde{\omega}(f,n\delta)_{p,\alpha,\beta} \leqslant C(p,\alpha,\beta,\lambda-\mu)\cdot n\widetilde{\omega}(f,\delta)_{p,\alpha,\beta} \quad , \quad n\delta < \lambda$$

ndërsa për çdo $\eta > 0$, plotësohet jobarazimi

$$\widetilde{\omega}(f,\eta\delta)_{p,\alpha,\beta} \leqslant C(p,\alpha,\beta,\lambda-\mu)\ [\eta+1]\ \widetilde{\omega}(f,\delta)_{p,\alpha,\beta} .$$

Vërtetimi: Nga këto katër veti, dy vetit e para janë plotësisht analoge me vetit e modulit të lëmueshmërisë ndërsa vetit 3) dhe 4) kanë një formë tjetër. Në këto veti paraqiten edhe konstantet të cilat konstante duke u bazuar në lemën 1.2 rrjedh se janë të fundme. Për thjeshtësi, më tej do të përdorim këto shenime:

$$f(\cos\theta) = \varphi(\theta) \ , \quad \varphi(x) = (1-x)^{\alpha}\ (1+x)^{\beta} \ ,$$

për $x = \cos\theta$, $\ell(\cos\theta) = (1-\cos\theta)^{\alpha}\ (1+\cos\theta)^{\beta} = w(\theta)$

Po vërtetojmë tani këto veti:

1) $f(x) \in L_{p,\alpha,\beta} \Leftrightarrow [\int_{-1}^{1} |f(x)|^p (1-x)^{\alpha p}(1+x)^{\beta p} dx]^{\frac{1}{p}} < \infty$

Duke bërë zavendësimin $x = \cos\theta$ në integralin:

$$I = \int_{-1}^{1} |f(x)|^p (1-x)^{\alpha p} (1+x)^{\beta p} dx$$

fitojmë: për $1 \leq p < \infty$;

$$I = \int_{0}^{\pi} |\varphi(\theta)|^p w^p(\theta) \sin\theta \, d\theta < \infty$$

ndërsa për $p = \infty$;

$$I = \max_{0 \leq \theta \leq \pi} |\varphi(\theta) \; w(\theta)| < \infty$$

Prandaj kemi:

$$\tilde{\omega}(f,\delta)_{p\,\alpha\,\beta} = \sup_{0 \leq t \leq \delta} \Big\{ [\int_{0}^{\pi-\lambda} |\varphi(\theta+t)-\varphi(\theta)|^p w^p(\theta) \sin\theta \, d\theta]^{\frac{1}{p}} +$$

$$+ [\int_{\lambda}^{\pi} |\varphi(\theta-t)-\varphi(\theta)|^p w^p(\theta) \sin\theta \, d\theta]^{\frac{1}{p}} \Big\} = I_1 + I_2 .$$

Le të jetë $1 \leq p < \infty$, atëherë kemi:

$$I_1 = [\int_{0}^{\pi-\lambda} |\varphi(\theta+t) - \varphi(\theta)|^p w^p(\theta) \sin\theta \, d\theta]^{\frac{1}{p}} \leq$$

$$\leq [\int_{0}^{\pi-\lambda} |\varphi(\theta+t)|^p w^p(\theta) \sin\theta \, d\theta]^{\frac{1}{p}} + [\int_{0}^{\pi-\lambda} |\varphi(\theta)|^p w^p(\theta) \sin\theta d\theta]^{\frac{1}{p}} =$$

$$= A_1 + A_2.$$

Eshtë e qartë se $A_2 < \infty$. Tani vlerësojmë integralin A_1. Në qoftë se në integralin A_1 zbatojmë lemën 1.1, kemi:

$$A_1 \leq C(p,\alpha,\beta,\lambda-\mu)\left[\int_0^{\pi-\lambda} |\varphi(\theta+t)|^p w^p(\theta+t)\sin(\theta+t)d\theta\right]^{\frac{1}{p}}$$

Bëjmë zëvendësimin $u = \theta + t$ dhe duke pasur parasyshë që $t \leq \mu < \lambda$, fitojmë:

$$A_1 \leq \left[\int_t^{\pi-\lambda+t} |\varphi(u)|^p w^p(u)\sin u\, du\right]^{\frac{1}{p}} \leq$$

$$\leq \left[\int_0^{\pi} |\varphi(u)|^p w^p(u)\sin u\, du\right]^{\frac{1}{p}} = I < \infty$$

Në mënyrë analoge vërtetohet, se $I_2 < \infty$.

Për $p = \infty$ kemi:

$$\tilde{\omega}(f,\delta)_{\infty,\alpha,\beta} = \sup_{0 \leq t \leq \delta} \left\{ \max_{0<\theta<\pi-\lambda} |[\varphi(\theta+t)-\varphi(\theta)]w(\theta)| + \right.$$

$$\left. + \max_{\lambda<\theta<\pi} |[\varphi(\theta-t)-\varphi(\theta)]\cdot w(\theta)| \right\} \leq$$

$$\leq \sup_{0<t<\delta} \left[\max_{0<\theta<\pi-\lambda} |\varphi(\theta+t)\ w(\theta)| + \max_{0<\theta<\pi-\lambda} |\varphi(\theta)w(\theta)| + \right.$$

$$\left. + \max_{\lambda<\theta<\pi} |\varphi(\theta-t)\ w(\theta)| + \max_{\lambda<\theta<\pi} |\varphi(\theta)\ w(\theta)|\right] .$$

Pa vështërsi vërtetohet se sejcili nga mbledhësit e shumës së mësipërme është më e vogël se I. Prandaj, fitojmë:

$$\tilde{\omega}(f,\delta)_{\infty,\alpha,\beta} < \infty .$$

2) Vetia rrjedh nga fakti se për vlerat më të mëdha të variablit δ kemi mundësi që supremumin ta shqyrtojmë në një bashkësi më të gjërë të vlerave të t-së.

3) Parametrin $t \in [0,\delta_1+\delta_2]$ po e paraqesim në formën $t = t_1 + t_2$, ku $t_1 \in [0,\delta_1]$ dhe $t_2 \in [0,\delta_2]$. Në këtë mënyrë kemi:

për $1 < p < \infty$:

$$\tilde{\omega}(f,\delta_1+\delta_2)_{p,\alpha,\beta} = \sup_{\substack{o<t_1<\delta_1\\ o<t_2<\delta_2}} \Big\{[\int_0^{\pi-\lambda} |\varphi(\theta+t_1+t_2) -$$

$$- \varphi(\theta)|^p w^p(\theta)\sin\theta\, d\theta]^{\frac{1}{p}} + [\int_\lambda^\pi |\varphi(\theta-t_1-t_2)-\varphi(\theta)|^p w^p(\theta)\sin\theta d\theta]^{\frac{1}{p}}\Big\} <$$

$$< \sup_{o<t_1<\delta_1} [\int_0^{\pi-\lambda} |\varphi(\theta+t_1+t_2)-\varphi(\theta+t_2)|^p w^p(\theta)\sin\theta\, d\theta]^{\frac{1}{p}} +$$

$$+ [\int_\lambda^\pi |\varphi(\theta-t_1-t_2)-\varphi(\theta-t_2)|^p w^p(\theta)\sin\theta\, d\theta]^{\frac{1}{p}} +$$

$$+ \sup_{o<t_2<\delta_2} [\int_0^{\pi-\lambda} |\varphi(\theta+t_2)-\varphi(\theta)|^p w^p(\theta)\sin\theta\, d\theta]^{\frac{1}{p}} +$$

$$+ [\int_\lambda^\pi |\varphi(\theta-t_2)-\varphi(\theta)|^p w^p(\theta)\sin\theta\, d\theta]^{\frac{1}{p}} < I_1' + I_1''$$

Eshtë e qartë se $I_1'' = \tilde{\omega}(f,\delta_2)_{p,\alpha,\beta}$. Shqyrtojmë tani I_1'. Kemi:

$$I_1' < J_1 + J_2$$

ku

$$J_1 = [\int_0^{\pi-\lambda} |\varphi(\theta+t_1+t_2)-\varphi(\theta+t_2)|^p w^p(\theta)\sin\theta\, d\theta]^{\frac{1}{p}} \text{ , dhe}$$

$$J_2 = [\int_{\lambda}^{\pi} |\varphi(\theta-t_1-t_2)-\varphi(\theta-t_2)|^p w^p(\theta)\sin\theta \, d\theta]^{\frac{1}{p}}$$

Në qoftë se në integralin J_1 zbatojmë lemën 1.1 kemi:

$$J_1 \leq C(p,\alpha,\beta,\lambda-\mu)[\int_0^{\pi-\lambda} |\varphi(\theta+t_1+t_2)-\varphi(\theta+t_2)|^p w^p(\theta+t_2)\sin(\theta+t_2)d\theta]^{\frac{1}{p}}$$

Bëjëmë zëvendësimin: $u = \theta+t_2$, kemi:

$$J_1 \leq C_1[\int_{t_2}^{\pi-\lambda+t_2} |\varphi(u+t_1)-\varphi(u)|^p w^p(u)\sin u \, du]^{\frac{1}{p}} \leq$$

$$\leq C_2[\int_0^{\pi-\lambda} |\varphi(u+t_1)-\varphi(u)|^p w^p(u)\sin u \, du]^{\frac{1}{p}} +$$

$$+ C_3[\int_{\pi-\lambda}^{\pi-\lambda+t_2} |\varphi(u+t_1)-\varphi(u)|^p w^p(u)\sin u \, du]^{\frac{1}{p}} \leq B_1 + B_2$$

Është e qartë se $B_1 \leq \tilde{\omega}(f,\delta_1)_{p,\alpha,\beta}$.

Shqyrtojmë tani B_2. Në qoftë se bëjmë zëvendësimin $v = u+t_1$, fitojmë:

$$B_2 \leq C_4[\int_{\pi-\lambda+t_2}^{\pi-\lambda+t_1+t_2} |\varphi(v)-\varphi(v-t_1)|^p w^p(v)\sin v \, dv]^{\frac{1}{p}} \leq$$

$$\leq C_5[\int_{\lambda}^{\pi} |\varphi(v)-\varphi(v-t_1)|^p w^p(v)\sin v \, dv]^{\frac{1}{p}} \leq C_5\tilde{\omega}(f,\delta_1)_{p,\alpha,\beta}$$

Në mënyrë analoge vërtetohet jobarazimi:

$$J_2 \leq C_6\tilde{\omega}(f,\delta_1)_{p,\alpha,\beta}.$$

Kështu vetia 3) është vërtetuar për $1 \leq p < \infty$, ndërsa për $p = \infty$ vërtetohet në mënyrë analoge.

4) Për $n = 1$, vetia është evidente. Për $n = 2$, kemi:

$$\tilde{\omega}(f,2\delta)_{p,\alpha,\beta} = \tilde{\omega}(f,\delta+\delta)_{p,\alpha,\beta}$$

Duke u bazuar në vetinë 3), kemi:

$$\tilde{\omega}(f,2\delta)_{p,\alpha,\beta} \leq C_7[\tilde{\omega}(f,\delta)_{p,\alpha,\beta} + \tilde{\omega}(f,\delta)_{p,\alpha,\beta}] \leq$$

$$\leq C_7 \; 2\tilde{\omega}(f,\delta)_{p,\alpha,\beta} .$$

Supozojmë se vetia vlenë për $n = k$, atëherë kemi:

$$\tilde{\omega}(f,(k+1)\delta)_{p,\alpha,\beta} \leq C_8[\tilde{\omega}(f,k\delta)_{p,\alpha,\beta} + \tilde{\omega}(f,\delta)_{p,\alpha,\beta}] \leq$$

$$\leq C_9(k+1)\tilde{\omega}(f,\delta)_{p,\alpha,\beta} .$$

1.4. DISA POHIME NDIHMËSE

Për vërtetimin e rezultateve themelore janë të nevojshme këto pohime ndihmëse:

Lema 1.2.[18] . Le të jetë $P_n(x)$ - polinom algjebrik i shkallës jo më të lartë se $n - 1$, $1 \leq p < \infty$ dhe $\alpha > -\frac{1}{2p}$

$\beta > -\frac{1}{2p}$ ndërsa $\alpha \geq 0$, $\beta \geq 0$ për $p = \infty$. Atëherë vlenë jobarazimi:

$$\| P_n'(x)\sqrt{1-x^2}\|_{p,\alpha,\beta} \leq Cn\| P_n(x)\|_{p,\alpha,\beta} .$$

Përkufizojmë funksionin e translacionit të përgjithshëm $f(x,t,\nu,\mu)$ në këtë mënyrë:

për $\nu = \mu = -\frac{1}{2}$:

$$f(x,t,\nu,\mu) = \frac{1}{2}[f(x\cos t + \sin t\sqrt{1-x^2}) + f(x\cos t - \sin t\sqrt{1-x^2})]$$

për $\nu = \mu > -\frac{1}{2}$:

$$f(x,t,\nu,\mu) = \frac{1}{\gamma(\nu)}\int_{-1}^{1} f(x\cos t + z\sin t\sqrt{1-x^2})(1-z^2)^{\nu-\frac{1}{2}}\,dz,$$

për $\nu > \mu = -\frac{1}{2}$:

$$f(x,t,\nu,\mu) = \frac{1}{\gamma(\nu)}\int_{-1}^{1} f(x\cos t + r\sin t\sqrt{1-x^2} - (1-r^2)(1-x)\sin^2\frac{t}{2})(1-r^2)^{\nu-\frac{1}{2}}\,dr,$$

për $\nu > \mu > -\frac{1}{2}$:

$$f(x,t,\nu,\mu) = \frac{1}{\gamma(\nu,\mu)}\int_{0}^{1}\int_{-1}^{1} f(x\cos t + rz\sin t\sqrt{1-x^2} - (1-r^2)(1-x)\sin^2\frac{t}{2})(1-r^2)^{\nu-\mu-1} r^{2\mu+1}(1-z^2)^{\mu-\frac{1}{2}}\,dz\,dr,$$

ku $\gamma(\nu) = \int_{-1}^{1}(1-r^2)^{\nu-\frac{1}{2}}\,dr$, dhe

$$\gamma(\nu,\mu) = \int_{0}^{1}\int_{-1}^{1}(1-r^2)^{\nu-\mu-1} r^{2\mu+1}(1-z^2)^{\mu-\frac{1}{2}}\,dz\,dr.$$

Lehtë shihet se $f(x,t,\nu,\mu) = f(x,-t,\nu,\mu)$, prandaj mund të konsiderojmë që $0 \leq t \leq \pi$.

Le të jenë dhënë numrat m dhe q. Na është e njohur se funksioni:

$$\gamma(t) = \left(\frac{\sin\frac{mt}{2}}{\sin\frac{t}{2}}\right)^{2q+4}$$

është polinom trigonometrik çift i rendit $(q+2)(m-1)$. Lehtë shihet se funksioni:

$$k(t,m,\nu,\mu) = \frac{\gamma(t)}{\gamma(m,\nu,\mu)}$$

ku $\gamma(m,\nu,\mu) = \int_0^{\pi} \gamma(t)(\sin\frac{t}{2})^{2\nu+1}(\cos\frac{t}{2})^{2\mu+1}dt$, $\nu \geq \mu \geq -\frac{1}{2}$,

për $\lambda \geq 0$ dhe $2q+2 > \lambda + 2\nu > -2$ plotëson kondítat:

$$\int_0^{\pi} k(t,m,\nu,\mu)(\sin\frac{t}{2})^{2\nu+1}(\cos\frac{t}{2})^{2\mu+1}dt = 1 \tag{1.10}$$

$$\int_0^{\pi} t^{\lambda} k(t,m,\nu,\mu)(\sin\frac{t}{2})^{2\nu+1}(\cos\frac{t}{2})^{2\mu+1}dt \leq C\, m^{-k} \tag{1.11}$$

konstanta C nuk varet nga m.

Lema 1.3. Në qoftë se funksioni $f(x) \in L_{p,\nu,\mu}$, $\nu \geq \mu \geq -\frac{1}{2}$, atëherë funksioni:

$$Q(x) = \int_0^{\pi} f(x,t,\nu,\mu)k(t,m,\nu,\mu)(\sin\frac{t}{2})^{2\nu+1}(\cos\frac{t}{2})^{2\mu+1}dt$$

është polinom algjebrik i shkallës jo më të lartë se $(q+2)(m-1)$.

Për $\nu = \mu = -\frac{1}{2}$ lema 1.3 është vërtetuar në punimin [31], për $\nu = \mu > -\frac{1}{2}$ në punimin [15], për $\nu > \mu > -\frac{1}{2}$ në punimin [16] dhe për $\nu > \mu = -\frac{1}{2}$ në punimin [17].

Lema 1.4. [16]. Në qoftë se $0 < r < 1$, $-1 \leqslant x \leqslant 1$, $-1 \leqslant z \leqslant 1$, ρ - një numër i çfarëdoshëm realë dhe:

$$x = y\cos t + RV\sqrt{1-y^2}\sin t - (1-R^2)(1-y)\sin^2\frac{t}{2},$$

$$z = \frac{(1-R^2+y+yR^2)\sin t - 2RV\cos t\sqrt{1-y^2}}{\sqrt{[(1-R^2+y+yR^2)\sin t - 2RV\cos t\sqrt{1-y^2}]^2 + 4R^2(1-V^2)(1-y^2}}$$

$$r = \sqrt{\frac{R^2(1-y)\cos^2\frac{t}{2} - RV\sqrt{1-y^2}\sin t + (1+y)\sin^2\frac{t}{2}}{4-[R^2(1-y)\sin^2\frac{t}{2} + RV\sqrt{1-y^2}\sin t + (1+y)\cos^2\frac{t}{2}}}$$

atëherë: $0 \leqslant R \leqslant 1$, $-1 \leqslant y \leqslant 1$, $-1 \leqslant V \leqslant 1$

$$(1-r^2)(1-x) = (1-R^2)(1-y)$$

$$r^2(1-z^2)(1-x^2) = R^2(1-V^2)(1-y^2)$$

$$x\sin t - rz\cos t\sqrt{1-x^2} + \frac{1}{2}(1-r^2)(1-x)\sin t = RV\sqrt{1-y^2}$$

$$x\cos t + rz\sin t\sqrt{1-x^2} + \frac{1}{2}(1-r^2)(1-x)\cos t = y + \frac{1}{2}(1-R^2)(1-y)$$

$$(1-x+\frac{1}{n^2})^\rho \leqslant C\,[1+(n|\sin\tfrac{t}{2}|)^{2|\rho|}]\,(1-y+\frac{1}{n^2})^\rho$$

$$(1+x+\frac{1}{n^2})^\rho \leqslant C\,[1+(n|\sin\tfrac{t}{2}|)^{2|\rho|}]\,(1+y+\sin^2\frac{t}{2})^\rho$$

$$(1-x+\frac{1}{n^2})^{\rho} < C\,[1+(n|\sin\frac{t}{2}|)^{-2\rho}]\,(1-y+\sin^2\frac{t}{2})^{\rho}$$

$$(1+x+\frac{1}{n^2})^{\rho} < C\,[1+(n|\sin\frac{t}{2}|)^{-2\rho}]\,(1+y+\sin^2\frac{t}{2})^{\rho}$$

konstanta C nuk varet nga x, t, y dhe n.

Lema 1.5. [18]. Le të jetë $Q_n(x)$ polinom algjebrik i shkallës jo më të lartë se $n-1$. Le të jenë dhënë numrat $p,\alpha,\beta,\rho_1,\rho_2$ të tillë që $1 < p < \infty$; $\alpha > -\frac{1}{2p}$, $\beta > -\frac{1}{2p}$, për $1 < p < \infty$; $\alpha > 0$, $\beta > 0$ për $p = \infty$, $-\infty < \rho_1 < \infty$, $-\infty < \rho_2 < \infty$, atëherë plotësohet jobarazimi:

$$\|Q_n'(x)(1-x)^{\alpha+\frac{1}{2}}(1+x)^{\beta+\frac{1}{2}}(1-x+\frac{1}{n^2})^{\rho_1}(1+x+\frac{1}{n^2})^{\rho_2}\|_{L_p}$$

$$< Cn\|Q_n(x)(1-x)^{\alpha}(1+x)^{\beta}(1-x+\frac{1}{n^2})^{\rho_1'}(1+x+\frac{1}{n^2})^{\rho_2}\|_{L_p}.$$

Për thjeshtësi do të përdorim këto shenime: $f(\cos\theta)=\varphi(\theta)$.

$$h(\theta,t) = h_{p,\alpha,\beta}^{\rho_1,\rho_2}(\theta,t) = (\sin\frac{\theta}{2})^{q(2\alpha+\frac{1}{p})}(\cos\frac{\theta}{2})^{q(2\beta+\frac{1}{p})}.$$

$$\cdot(\sin^2\frac{\theta}{2}+t^2)^{\rho_1 q}(\cos^2\frac{\theta}{2}+t^2)^{\rho_2 q},$$ ku $q = p$ për $1 < p < \infty$ dhe $q = 1$ për $p = \infty$.

Lema 1.6. Në qoftë se $\alpha > -\frac{1}{2p}$, $\beta > -\frac{1}{2p}$, atëherë për $\frac{\pi}{n} - t < \theta < \frac{\pi}{n}$, $0 < t < \frac{\pi}{n}$, $n > 2$, plotësohet jobarazimi:

$$h(\theta-t,\frac{1}{n}) < C_1 h(\theta,\frac{1}{n}) \tag{1.12}$$

për $\frac{\pi}{n} + t \leq \theta \leq \frac{3\pi}{n}$, $0 \leq t \leq \frac{\pi}{2n}$, plotësohet jobarazimi:

$$h(\theta+t,\tfrac{1}{n}) \leq C_2 h(\theta,\tfrac{1}{n}) \tag{1.13}$$

konstantet C_1 dhe C_2 nuk varen nga θ, t dhe n.

Vërtetimi: Me të vërtetë, duke u bazuar në kondidat $\alpha > -\frac{1}{2p}$, $\beta > -\frac{1}{2p}$ si dhe në jobarazimet:

$$\sin^2\frac{\theta-t}{2} \leq 2(\sin^2\frac{\theta}{2} + \sin^2\frac{t}{2});\ \cos^2\frac{\theta-t}{2} \leq 2(\cos^2\frac{\theta}{2} + \sin^2\frac{t}{2})$$

$$\sin^2\frac{\theta}{2} \leq 2(\sin^2\frac{\theta-t}{2}+\sin^2\frac{t}{2});\ \cos^2\frac{\theta}{2} \leq 2(\cos^2\frac{\theta-t}{2}+\sin^2\frac{t}{2}) \tag{1.14}$$

$$|\sin\frac{\theta-t}{2}| \leq |\sin\frac{\theta}{2}| + |t|\ ;\ |\cos\frac{\theta-t}{2}| \leq |\cos\frac{\theta}{2}| + |t|$$

kemi:

$$h(\theta-t,\tfrac{1}{n}) = h(\theta,\tfrac{1}{n})\frac{(\sin\frac{\theta-t}{2})^{2\alpha p+1}(\cos\frac{\theta-t}{2})^{2\beta p+1}(\sin^2\frac{\theta-t}{2}+\frac{1}{n^2})^{\rho_1 p'}}{(\sin\frac{\theta}{2})^{2\alpha p+1}(\cos\frac{\theta}{2})^{2\beta p+1}(\sin^2\frac{\theta}{2}+\frac{1}{n^2})^{\rho_1 p}}\cdot$$

$$\cdot\frac{(\cos^2\frac{\theta-t}{2}+\frac{1}{n^2})^{\rho_2 p}}{(\cos^2\frac{\theta}{2}+\frac{1}{n^2})^{\rho_2 p}} \leq C_3 h(\theta,\tfrac{1}{n})\left(\frac{\sin\frac{\theta}{2}+\frac{1}{n}}{\sin\frac{\theta}{2}}\right)^{2\alpha p+1}\left(\frac{\cos\frac{\theta}{2}+\frac{1}{n}}{\cos\frac{\theta}{2}}\right)^{2\beta p+1}$$

$$\leq C_4 h(\theta,\tfrac{1}{n})\left(1+\frac{1}{n\sin\frac{\theta}{2}}\right)^{2\alpha p+1} \leq C_5 h(\theta,\tfrac{1}{n}).$$

Po ashtu duke u bazuar në kondititat e dhëna si dhe në jobarazimet (1.14) për $\alpha > -\frac{1}{2p}$, $\beta > -\frac{1}{2p}$ do të kemi:

$$\frac{h(\theta+t,\frac{1}{n})}{h(\theta,\frac{1}{n})} = \frac{|\sin\frac{\theta+t}{2}|^{2\alpha p+1}|\cos\frac{\theta+t}{2}|^{2\beta p+1}(\sin^2\frac{\theta+t}{2}+\frac{1}{n^2})^{\rho_1 p}}{|\sin\frac{\theta}{2}|^{2\alpha p+1}|\cos\frac{\theta}{2}|^{2\beta p+1}(\sin^2\frac{\theta}{2}+\frac{1}{n^2})^{\rho_1 p}} \cdot$$

$$\cdot\frac{(\cos^2\frac{\theta+t}{2}+\frac{1}{n^2})^{\rho_2 p}}{(\cos^2\frac{\theta}{2}+\frac{1}{n^2})^{\rho_2 p}} < C_6\left(\frac{|\sin\frac{\theta}{2}|+\frac{1}{n}}{|\sin\frac{\theta}{2}|}\right)^{2\alpha p+1}\left(\frac{|\cos\frac{\theta}{2}|+\frac{1}{n}}{|\cos\frac{\theta}{2}|}\right)^{2\beta p+1} \leqslant$$

$$< C_6\left(1+\frac{1}{n|\sin\frac{\theta}{2}|}\right)^{2\alpha p+1}\left(1+\frac{1}{n|\cos\frac{\theta}{2}|}\right)^{2\beta p+1} <$$

$$< C_7\left(1+\frac{1}{n\theta}\right)^{2\alpha p+1}\left(1+\frac{1}{n\sin\frac{\pi}{4n}}\right)^{2\beta p+1} < C_8 \; .$$

Në mënyrë analoge vërtetohet kjo lemë.

Lema 1.7. Në qoftë se $2p\alpha+1 > 0$ dhe $2p\beta+1 \geqslant 0$, atëherë ekzistojnë konstantet C_1, C_2 dhe C_3 për të cilat plotësohen jobarazimet:

